

31991L0250

Direktiva e Këshillit 91/250/KEE e 14 majit 1991 për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike

Gazeta Zyrtare L 122, 17/05/1991 fq. 0042-0046

Botim i veçantë finlandez: kapitulli 17, volumni 1 fq. 0111

Botim i veçantë suedez: kapitulli 17, volumni 1 fq. 0111

Direktiva e Këshillit e 14 majit 1991 për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike (91/250/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Europian dhe në veçanti nenin 100 a të tij,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni [1],

Në bashkëpunim me Parlamentin Europian [2],

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Duke pasur parasysh se programet kompjuterike aktualisht nuk janë qartësisht të mbrojtura në të gjithë Shtetet Anëtare nga legjislacioni ekzistues, dhe aty ku kjo mbrojtje ekziston, ka cilësi të ndryshme;

Duke pasur parasysh se zhvillimi i programeve kompjuterike kërkon investim të konsiderueshëm burimesh njerëzore, teknike dhe financiare ndërkohë që programet kompjuterike mund të kopjohen me një fraksion të kostos së nevojshme për zhvillimin e tyre të pavarur;

Duke pasur parasysh se programet kompjuterike po luajnë një rol të rëndësishëm e gjithmonë në rritje në një gamë të gjerë industrish, dhe teknologjia e programeve kompjuterike mund të konsiderohet respektivisht si e një rëndësie thelbësore për zhvillimin industrial të Komunitetit;

Duke pasur parasysh se disa ndryshime në mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike, sipas ligjeve të Shteteve Anëtare kanë efekte të drejtpërdrejta dhe negative mbi funksionimin e tregut të përbashkët, për sa i përket programeve kompjuterike, dhe këto ndryshime mund të zgjerohen me hartimin e legjislacionit të ri në Shtetet Anëtare me këtë subjekt;

Duke pasur parasysh se ndryshimet ekzistuese që kanë të tilla efekte duhen shfuqizuar dhe duhet parandaluar krijimi i atyre të reja, ndryshime të cilat nuk ndikojnë në masë të konsiderueshme funksionimin e tregut të përbashkët, nuk është e nevojshme të shfuqizohen ose të parandalohet krijimi i tyre;

Duke pasur parasysh se kuadri ligjor i Komunitetit mbi mbrojtjen e programeve kompjuterike, mundet respektivisht të kufizohet në instancën e parë mbi garantimin e mbrojtjes së programeve kompjuterike në Shtetet Anëtare, në bazë të ligjit mbi të drejtën e autorit si krijime letrare dhe më tej mbi sanksionimin se cili dhe çfarë duhet mbrojtur, të drejtat ekskluzive mbi të cilat personat e mbrojtur duhet të kenë mundësi të mbështeten për autorizimin ose ndalimin e akteve të veçanta dhe për sa kohë duhet të zbatohet mbrojtja;

Duke pasur parasysh se, për qëllim të kësaj direktive, termi “program kompjuterik” do të përfshijë programe të cilësdo formë, duke përfshirë ato të trupëzuara në harduer; duke pasur parasysh se ky term gjithashtu përfshin edhe punën përgatitore të projektimit për zhvillimin e një programi kompjuterik, por vetëm nëse kjo punë përgatitore është e një natyre të tillë që siguron krijimin e një programi kompjuterik në një fazë të mëvonshme;

Duke pasur parasysh se, në zbatim të kriterëve që do të zbatohen për të përcaktuar nëse një program kompjuterik është ose jo një veprë origjinale, nuk duhet të zbatohen teste mbi meritat cilësore ose estetike të programit kompjuterik;

Duke pasur parasysh se Komuniteti është plotësisht i angazhuar për nxitjen e standardizimit ndërkombëtar;

Duke pasur parasysh se funksioni i një programi kompjuterik është të komunikojë dhe punojë së bashku me komponentë të tjerë të një sistemi kompjuterik dhe me përdorues, dhe për këtë qëllim kërkohet një ndërlidhje logjike dhe sipas rastit fizike, dhe ndërveprim për të mundësuar të gjithë elementët e softuer-it dhe të harduer-it të punojnë me të tjerë softuerë dhe harduerë dhe me përdorues në të gjitha mënyrat që janë synuar të funksionojnë;

Duke pasur parasysh se pjesët e programit të cilat sigurojnë një ndërlidhje dhe ndërveprim të tillë ndërmjet elementeve të softuer-it dhe harduer-it janë përgjithësisht të njohur si “ndërfaqe”;

Duke pasur parasysh se kjo ndërlidhje dhe ndërveprim funksional është përgjithësisht i njohur si “ndërveprim”, duke pasur parasysh se ky ndërveprim mund të përkufizohet si aftësia për të shkëmbyer informacion dhe për të përdorur në mënyrë të ndërsjellët informacionin e shkëmbyer;

Duke pasur parasysh se, për shmangien e dyshimit, është sqaruar që vetëm shprehja e një programi kompjuterik është e mbrojtur dhe që idetë dhe metodat që qëndrojnë pas secilit element të një programi, përfshirë edhe ato që qëndrojnë pas ndërfaqeve, nuk janë të mbrojtura mbi të drejtën e autorit nga kjo direktivë;

Duke pasur parasysh se, në përputhje me parimin e të drejtës së autorit, në masën që gjuhët logjike, të algoritmeve dhe të programimit përbajnë ide dhe metoda, këto ide dhe metoda nuk janë të mbrojtura nga kjo direktivë;

Duke pasur parasysh se, në përputhje me legjislacionin dhe jurisprudencën e Shteteve Anëtare dhe të konventave ndërkombëtare mbi të drejtën e autorit, shprehja e këtyre ideve dhe metodave do të mbrohet nga e drejta e autorit;

Duke pasur parasysh se, për qëllime të kësaj direktive, termi “qira” do të thotë të bësh të vlefshëm për përdorim një program kompjuterik ose një kopje të tij për një periudhë të kufizuar kohe dhe për qëllime fitimprurëse; duke pasur parasysh se ky term nuk përfshin huazimin publik, i cili mbetet respektivisht jashtë sferës së kësaj direktive;

Duke pasur parasysh se, të drejtat ekskluzive të autorit për ndalimin e riprodhimit të paautorizuar të punës së tij duhet të jenë subjekt i një përjashtimi të kufizuar në rastin e një programi kompjuterik, për të lejuar riprodhimin e domosdoshëm teknik për përdorimin e këtij programi nga përdoruesi i ligjshëm;

Duke pasur parasysh se kjo do të thotë që veprimet e domosdoshme të ngarkimit dhe përdorimit për shfrytëzimin e një kopjeje ligjore të programit, si dhe veprimi i korrektimit të gabimeve të tij, nuk mund të pengohen me kontratë; duke pasur parasysh se, në mungesë të dispozitave specifike kontraktuese, përfshirë edhe rastet e shitjes së një kopjeje të programit, çdo veprim tjetër i domosdoshëm për shfrytëzimin e kopjes së programit mund të kryhet sipas synimit nga një blerës i ligjshëm i kësaj kopjeje;

Duke pasur parasysh se një person që ka të drejtën e përdorimit të një programi kompjuterik nuk duhet të pengohet nga kryerja e veprimeve të domosdoshme të vërejtjes, studimit ose testimit të funksionimit të programit, vetëm nëse këto veprime nuk shkelin të drejtën e autorit mbi programin;

Duke pasur parasysh se riprodhimi, përkthimi, përshtatja ose transformimi i paautorizuar i formës së kodit në të cilin është disponuar një kopje e një programi kompjuterik përbën shkelje të së drejtave ekskluzive të autorit;

Duke pasur parasysh se, megjithëse, mund të ekzistojnë rrethana kur një riprodhim i tillë i kodit dhe përkthim i formës së tij sipas kuptimit të nenit 4 gërmat a dhe b janë të domosdoshëm për të përfituar informacionin e nevojshëm për arritjen e ndërveprimit të një programi të pavarur me programe të tjerë;

Duke pasur parasysh se, duhet konsideruar që vetëm në të tilla rrethana të kufizuara, kryerja e veprimeve të riprodhimit dhe përkthimit nga një person që ka të drejtën e shfrytëzimit të një kopjeje të një programi, ose në interes të tij, është e ligjshme dhe në përputhje me praktikën e ndershme, dhe për rrjedhojë duhet konsideruar e zhveshur nga nevoja për të pasur autorizimin e mbajtësit të së drejtës së autorit;

Duke pasur parasysh se një synim i këtij përjashtimi është mundësia e lidhjes së të gjithë komponentëve të një sistemi kompjuterik, përfshirë këtu komponentët e krijuar nga prodhues të ndryshëm, në mënyrë që ata të funksionojnë bashkërisht,;

Duke pasur parasysh se një përjashtim i tillë nga të drejtat ekskluzive të autorit nuk mund të përdoret në mënyra që cenojnë interesat legjitime të mbajtësit të së drejtës së autorit ose që krijojnë konflikt me përdorimin normal të programit;

Duke pasur parasysh se, në mënyrë që të mbetet brenda kuadrit të dispozitave të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, afati i mbrojtjes i referohet jetëgjatësisë së autorit dhe pesëdhjetë viteve nga 1 janari i vitit pasardhës të vitit të vdekjes së tij, ose në rastin e një veprë anonime ose pseudonime, 50 vjet nga 1 janari i vitit pasardhës të vitit në të cilin vepra është botuar për herë të parë;

Duke pasur parasysh se mbrojtja e programeve kompjuterike me anë të ligjeve të së drejtës së autorit duhet të bëhet pa dëmtuar zbatimin, në rastet e përshtatshme, të formave të tjera të mbrojtjes; duke pasur parasysh se, megjithëse, çdo dispozitë kontraktuese në kundërshtim me nenin 6 ose me përjashtimet e parashikuara në nenin 5 pikat 2 dhe 3 do të konsiderohet e shfuqizuar dhe e paqenë;

Duke pasur parasysh se dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë zbatimin e rregullave të konkurrencës sipas neneve 85 dhe 86 të traktatit, nëse një furnitor dominues refuzon të vërë në dispozicion informacionet e nevojshme për ndërveprim siç është përkufizuar në këtë direktivë;

Duke pasur parasysh se dispozitat e kësaj direktive nuk duhet të cenojnë kërkesat specifike të legjislacionit Komunitar ekzistues në lidhje me botimin e ndërfaqeve në sektorin e telekomunikacioneve ose vendimeve të Këshillit, në lidhje me standardizimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit;

Duke pasur parasysh se kjo direktivë nuk ndikon mbi shmangiet e parashikuara në legjislacionin kombëtar në përputhje me Konventën e Bernës mbi çështjet që nuk mbulohen nga kjo direktivë,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

Neni 1

Objekti i mbrojtjes

1. Në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, Shtetet Anëtare do të mbrojnë programet kompjuterike me të drejta autori, si vepra letrare brenda kuptimit të Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike. Për qëllimet e kësaj direktive, termi “program kompjuterik” do të përfshijë materialin e projektit përgatitor të tyre.

2. Mbrojtja, në përputhje me këtë direktivë, do të zbatohet për shfaqjen në cilëndo formë të një programi kompjuterik. Idetë dhe metodat që qëndrojnë pas cilitdo element të një programi kompjuterik, përfshirë ato që qëndrojnë pas ndërfaqeve të tij, nuk mbrohen me të drejtën e autorit nga kjo direktivë.
3. Një program kompjuterik do të mbrohet, nëse është origjinal, në kuptimin që krijimi intelektual është i vetë autorit. Nuk do të zbatohet asnjë kriter tjetër për të përcaktuar pranueshmërinë e tij për mbrojtje.

Neni 2

Autorësia e një programi kompjuterik

1. Autori i një programi kompjuterik konsiderohet personi fizik ose grupi i personave fizikë që kanë krijuar programin, ose aty ku lejon legjislacioni i Shteteve Anëtare, personi juridik i përcaktuar si mbajtës i së drejtës nga ai legjislacion. Kur veprat kolektive njihen nga legjislacioni i një Shteti Anëtar, personi i konsideruar nga legjislacioni i Shtetit Anëtar si krijuesi i veprës do të jetë autori i saj.
2. Për sa i përket një programi kompjuterik të krijuar në bashkëpunim nga një grup personash fizikë, të drejtat ekskluzive do të zotërohen në grup.
3. Kur një program kompjuterik është krijuar nga një i punësuar në zbatim të detyrave të tij ose të porosive të dhëna nga punëdhënësi i tij, punëdhënësi quhet ushtruesi ekskluziv i të gjitha të drejtave ekonomike mbi këtë program, me përjashtim të rasteve kur kushtëzohet ndryshe në kontratë.

Neni 3

Përfituesit e mbrojtjes

Mbrojtja i akordohet të gjithë personave fizikë ose juridikë të pranuar nga legjislacionet kombëtare mbi të drejtën e autorit, sikurse zbatohet për veprat letrare.

Neni 4

Veprime të kufizuara

Subjekti i dispozitave të neneve 5 dhe 6, të drejtat ekskluzive të mbajtësit të të drejtave sipas kuptimit të nenit 2, do të përfshijnë të drejtën për të bërë ose autorizuar:

- (a) riprodhimin e përhershëm ose të përkohshëm të një programi kompjuterik me cilindo mjet dhe në çdo formë, pjesërisht ose tërësisht. Për sa kohë që për ngarkimin, shfaqjen, përdorimin, transmetimin ose ruajtjen e programit kompjuterik nevojitet një riprodhim i tillë, këto veprime do t'i nënshtrohen autorizimit nga ana e mbajtësit së të drejtës;
- (b) përkthimin, përshtatjen, rregullimin dhe çdo ndryshim tjetër të një programi kompjuterik dhe riprodhimin e rezultateve të këtyre veprimeve, pa cenuar të drejtën e personit i cili bën ndryshimet në program;
- (c) çdo formë të shpërndarjes në publik, përfshirë huazimin, të programit kompjuterik origjinal ose të kopjeve të tij. Shitja e parë brenda Komunitetit e një kopjeje të një programi nga mbajtësi i së drejtës ose me miratimin e tij do të heqë të drejtën e shpërndarjes brenda Komunitetit të asaj kopjeje, me përjashtim të së drejtës për të kontrolluar huazime të mëtejshme të programit ose kopjeve të tij.

Neni 5

Përjashtime nga veprimet e kufizuara

1. Në mungesë të dispozitave kontraktuese specifike, veprimet e përmendura në nenin 4 pikat a dhe b nuk kërkojnë autorizim nga mbajtësi i së drejtës në rastet kur ato janë të domosdoshme për përdorimin e

programit kompjuterik nga ana e përvetësuesit të ligjshëm në përputhje me qëllimin e synuar, përfshirë dhe korrigjimin e gabimeve.

2. Bërja e një kopjeje rezervë (back-up copy) nga një person që ka të drejtën e përdorimit të një programi kompjuterik nuk mund të ndalohej me kontratë, për sa kohë që është e domosdoshme për atë shfrytëzim.
3. Personi që ka të drejtën e përdorimit të një kopjeje të një programi kompjuterik ka të drejtë, pa autorizimin e mbajtësit të së drejtës së autorit, të vërejë, studiojë ose provojë funksionimin e programit për të përcaktuar idetë dhe metodat që qëndrojnë pas çdo elementi të programit, nëse ai e bën këtë gjatë kryerjes së veprimeve të ngarkimit, shfaqjes, përdorimit, transmetimit ose ruajtjes së programit mbi të cilin ka të drejtën.

Neni 6 Zbërthimi

1. Nuk kërkohet autorizim nga mbajtësi i të drejtës së autorit në rastet kur riprodhimi i kodit dhe përkthimi i formës së tij, sipas kuptimit të nenit 4 pikat (a) dhe (b), janë të domosdoshëm për të përfituar informacionin e duhur për sigurimin e ndërveprimit të një programi të pavarur me programe të tjerë, vetëm nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - (a) këto veprime kryhen nga një i licensuar ose nga një person tjetër që ka të drejtën e shfrytëzimit të një kopjeje të një programi, ose në interes të tyre nga një person i autorizuar për t'i kryer;
 - (b) informacionet e nevojshme për sigurimin e ndërveprimit nuk kanë qenë lehtësisht të disponueshëm për personat të cilëve i referohemi në nënparagrafin a dhe, c këto veprime kufizohen vetëm mbi pjesët e programit origjinal që janë të nevojshme për të siguruar ndërveprimin.
2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk lejojnë që informacioni i përfituar nga zbatimi i tij:
 - (a) të përdoret për qëllime të tjera përveç sigurimit të ndërveprimit të programit të krijuar në mënyrë të pavarur;
 - (b) t'i jepet të tjerëve, me përjashtim të rasteve kur është e domosdoshme për ndërveprimin e programin të krijuar në mënyrë të pavarur; ose c të përdoret për zhvillimin, prodhimin ose tregtimin e një programi kompjuterik dukshëm të ngjashëm në paraqitjen e tij, ose për çdo veprim tjetër që cenon të drejtën e autorit.
3. Në përputhje me dispozitat e Konventës së Bernës për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike, parashikimet e këtij neni nuk mund të interpretohen në mënyrë që të lejojnë zbatimin e tij në kushte të paarsyeshme, që cenojnë interesat legjitime të mbajtësit të së drejtës së autorit ose që kundërshtojnë shfrytëzimin normal të një programi kompjuterik.

Neni 7 Masa të veçanta mbrojtjeje

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 4, 5, dhe 6, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, dëmshpërblime të përshtatshme kundrejt një personi që kryen çdo veprim të përmendur në nënparagrafët a, b dhe c si më poshtë:
 - (a) çdo veprim i vënies në qarkullim të një kopjeje të një programi kompjuterik duke ditur, ose duke pasur arsye të besojë, që është një kopje në shkelje të së drejtave të autorit;
 - (b) zotërimi, për qëllime tregtimi, i një kopjeje të një programi kompjuterik duke ditur, ose duke pasur arsye të besojë, që është një kopje në shkelje të së drejtave të autorit;

- (c) çdo veprim i vënies në qarkullim, ose zotërimi për qëllime tregtimi i çdo mjeti, qëllimi i vetëm i të cilit është të lehtësojë heqjen e paautorizuar ose shmangien e çfarëdo pajisjeje teknike që mund të jetë montuar për të mbrojtur një program kompjuterik.
2. Çdo kopje e një programi kompjuterik në shkelje të së drejtave të autorit është e konfiskueshme në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar përkatës.
 3. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë edhe konfiskimet e mjeteve të përmendura në paragrafin 1 germa c.

Neni 8 **Afati i mbrojtjes**

1. Mbrojtja jepet për jetëgjatësinë e autorit dhe për pesëdhjetë vjet pas vdekjes së tij ose pas vdekjes së autorit të fundit që jeton, kur programi kompjuterik është vepër anonime ose pseudonime, ose kur një person juridik është përcaktuar si autor nga legjislacioni kombëtar në përputhje me nenin 2 pika 1, afati i mbrojtjes do të jetë pesëdhjetë vjet nga koha që programi kompjuterik të jetë venë ligjërisht në dispozicion të publikut. Afati i mbrojtjes fillon në 1 janar të vitit pasardhës të ngjarjeve të lartpërmendura.
2. Shtetet Anëtare, të cilat kanë tashmë një afat mbrojtjeje më të gjatë se ai i parashikuar në paragrafin 1, lejohen të ruajnë afatin e tyre aktual deri në momentin kur afati i mbrojtjes për veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit do të harmonizohet më përgjithësisht nga legjislacioni Komunitar.

Neni 9 **Zbatimi në vazhdimësi i dispozitave të tjera ligjore**

1. Dispozitat e kësaj direktive nuk cenojnë asnjë dispozitë tjetër ligjore, si për shembull ato që lidhen me të drejtat e patentave, markave tregtare, konkurrencës së pandershme, sekreteve tregtare, mbrojtjes së produkteve gjysmë përçuese ose të ligjit të kontratës. Çdo dispozitë kontraktuese në kundërshtim me nenin 6 ose me përjashtimet e përmendura në nenin 5 pikat 2 dhe 3 është e shfuqizuar dhe i paqenë.
2. Dispozitat e kësaj direktive zbatohen edhe për programet e krijuara përpara 1 janarit 1993 pa cenuar asnjë vepër të përfunduar dhe të drejtë të përfituar përpara kësaj date.

Neni 10 **Dispozita përfundimtare**

1. Shtetet Anëtare do të sigurojnë përpara 1 janarit 1993 hyrjen në fuqi të ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të nevojshme për t'u pajtuar me këtë direktivë.

Kur Shtetet Anëtare marrin këto masa, ato do të përmbajnë një referencë për këtë direktivë ose do të shoqërohen nga një referencë e tillë kur bëhet botimi zyrtar i tyre. Metoda e bërjes së një reference të tillë do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare do t'i komunikojnë Komisionit dispozitat e legjislacionit kombëtar që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo direktivë.

Neni 11

Kjo direktivë i adresohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 14 maj 1991.

Për Këshillin

Presidenti

J. F. Poos

(1) GZ nr. C 91, 12.04.1989, fq. 4; dhe GZ nr. C 320, 20.12.1990, fq. 22.

(2) Nr. C 231, 17.09.1990, fq. 78; dhe vendimi i 17 prillit 1991 ende e pabotuar në Gazetën Zyrtare).

(3) GZ nr. C 329, 30.12.1989, fq. 4.